

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga kryetarja e kolegjit Tonka Berishaj, Fillim Skoro, gjyqtar referues dhe Hava Haliti, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Kimete Veseli si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve S.B., F.K.1., F.K.2., F.K.3., M.K., që të gjithë nga Prishtina, e A.N., nga Shtimja, për shkak te veprës penale në bashkëkryerje kontrabandimi me migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, të akuzuarit F.K.1. e A.N., edhe për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-se, ndërsa i akuzuari G.U., për shkak te veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale kontrabandimi me migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK, për te vendosur sipas ankesave të mbrojtësit të akuzuarit S.B., av.N.R., të mbrojtësve të akuzuarit F.K.1., av.L.B., të mbrojtësit të akuzuarit F.K.2., av.B.K., mbrojtësit te akuzuarit F.K.3., av.B.E. dhe mbrojtësit të akuzuarit A.N., av.M.N., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr 405/2016,të dt.16.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.06.11.2018, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.N. dhe F.K.1., për veprat penale më afër të përshkruara si në dispozitivin I/1, dhe II/2, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.405/2016, të dt.16.05.2018, për këtë pjesë vërtetohet.

II. Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve S.B., av.N.R., F.K.1., av.L.B., F.K.2., av.B.K., F.K.3., av.B.E., M.K., A.N., av.M.N., dhe G.U., edhe sipas detyrës zyrtare anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.405/2016, të dt.16.05.2018, më afër i përshkruar si në dispozitivin I dhe II, dhe çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR:nr.405/2016, të dt.16.05.2018, të akuzuarit S.B., F.K.1., F.K.2., F.K.3., M.K., A.N. dhe A.U., janë shpallur fajtor për veprën penale kontrabandimi me migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, dhe gjykata të akuzuarit S.B., ia ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 4(katër)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1.500(njëmijepesëqind)Euro, të akuzuarit F.K.1., dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite dhe dënimin me gjobë në shumë prej 6.000(gjashtëmijë)Euro, për veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve dhe substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1

të KPRK, e shpall fajtor dhe ia shqipton dënimin në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300(treqind)Euro, dhe për dy vepra penale ia shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 3(tri)vite e 3(tre)muaj.

Të akuzuarit F.K.2., ia shqipton dënimin me burgim prej 1(një)vit e 7(shtatë)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)Euro, të akuzuarit F.K.3., ia shqipton dënimin me burgim prej 1(një)vit e 7(shtatë)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 2.000(dymijë)Euro, të akuzuarit M.K., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje 1(një)vit e 4(katër)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 2.500(dymijepesëqind)Euro, të akuzuarit A.N., ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 4(katër)muaj si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200(dyqind)Euro, dhe e shpall fajtor për veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 272 par.2 të KPRK, dhe ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 200(dyqind)Euro, dhe për dy vepra penale ia shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 4(katër)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1.700(njëmijeshatëqind)Euro, të akuzuarit G.U., për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale kontrabandimi me migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK, ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 7(shtatë)muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)Euro. Të akuzuarve në dënimet e shqiptuara do t'iu llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak.

Të akuzuarit janë të obliguar që gjambat ti paguajnë brenda afatit e jo më gjatë se tre muaj, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, në të kundërtën gjykata dënimet e shqiptuara me gjobë do ti zëvendësojë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgim me 20 Euro, të dënimit me gjobë.

Të akuzuarit secili prej tyre veç e veç, janë të obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 100Euro.

Gjykata në bazë të nenit 62 par.2 nën par.2 pika 2.6 dhe neni 69 të KPRK, të akuzuarve i shqipton dënim plotësues konfiskim të përhershëm të sendeve të luajtshme të përdorura si mjete të kryerjes së veprës penale dhe sendet që janë objekt i kryerjes së veprës penale, si në vazhdim:

-Të gjitha pajisjet e përdorura për prodhimin e falsifikuara të sekuestruara në banesë në Fushë Kosovë, rr."....., si dhe në banesën në Prishtinë, rr."....., të precizuara në raportin e ekspertimit nga AKF2016-0077 të dt.20.10.2016, të gjitha dokumentet e falsifikuara të sekuestruara, nga banesat e sipërshënuara, të precizuara në raportin e ekspertimit AKF/2016-008/2016-75, të dt.02.03.2016, si dhe nga vendbanimet e të akuzuarve S.B., M.K. dhe A.N., sipas vërtetimeve mbi sekuestrimin të përkohshëm të sendeve të dt.09.12.2015.

-Substancave narkotike e sekuestruar nga të akuzuarit F.K.1., në peshë prej 6.22gr dhe substancave narkotike e sekuestruar nga A.N., në peshë prej 0.92gr.

Kundër këtij, aktgjykimi në afat ankesë kanë ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B., av.N.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të

aprovohet dhe të akuzuarin S.B. ta shpallë të pa fajshëm dhe ta liroj nga akuza ose çështjen penale ta anuloj dhe ta kthej në rigjykim dhe vendim.

Mbrojtësja e të akuzuarit F.K.1., av.L.B., për shkakë të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin dhe të akuzuarin F.K.1. ta liroj nga akuza ose çështjen penale ta anuloj dhe ta kthej në rigjykim dhe vendim.

Mbrojtësit e të akuzuarve F.K.2., av.B.K. dhe F.K.3., av.B.E., për shkakë të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarit të lirohen nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.N., av.M.N., për shkakë të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, të akuzuarin ta liroj nga akuza ose çështjen penale ta kthej në rigjykim dhe vendim, ose aktgjykimin ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj PPA/I.nr.430/2018, të dt.19.09.2016, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve S.B., F.K.1., F.K.2., F.K.3. dhe A.N., ka propozuar që ankesat të refuzohen si të pabazuara ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, caktoi seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë: i akuzuari S.B., dhe mbrojtësi i tij, av.N.R., F.K.1. dhe mbrojtësja e tij L.B., i akuzuari F.K.2., mbrojtësi i tij, av.B.K., i akuzuari F.K.3., mbrojtësi i tij, av.B.E., i akuzuari M.K., i akuzuari A.N. dhe mbrojtësi i tij, av.M.N. dhe i akuzuari G.U., ndërsa ka munguar Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, edhe pse është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca është mbajtur në mungesë të tyre, në pajtim të nenit 390 par.4 të KPP.

Gjykata e Apelit, konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, duke vlerësuar ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, duke marrë parasysh edhe mendimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.N. dhe F.K.1., për veprat penale më afër të përshkuara si në dispozitivin I/1, dhe II/2, refuzohen si të pabazuara ndërsa,

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve S.B., av.N.R., F.K.1., av.L.B., F.K.2., av.B.K., F.K.3., av.B.E., dhe A.N., av.M.N., për veprën penale të përshkruar si në dispozitivin I,dhe II të aktgjykimit janë të bazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B., av.N.R., në ankesën e tij, pretendon se aktgjykimi është mbështetur në provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, në bazë të supozimeve dhe paragjyqimeve, mirëpo, gjykata të

akuzuarin S.B., e ka shpall fajtor për veprën penale kontrabandimi me migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, e në bazë të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.1.8 të KPP, gjykata aktgjykimin nuk e ka bazuar në prova të nxjerrë në shqyrtimin gjyqësor dhe nuk ka vlerësuar provat me ndërgjegje siç parasheh dispozita e neni 361 të KPP. Gjykata ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e neni 123 par.2 lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve, dhe në kundërshtim me dispozitën e neni 132 të KPK, ku nuk janë afruar mundësitë për të parashtruar pyetje dëshmitarëve, si pasoje e këtyre është shkelur ligji penal nga neni 385 par.1 nën par.1.2 dhe 1.3 të KPP, se ekzistojnë rrethana që parashtrajnë ndjekjen penale. Në shkesat e lëndës ekzistojnë vetëm raporte policore dhe ato raporte njoftuese dhe nuk është përshkruar me asnjë dëshmi për të parë se a është formuar figura e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Si pasoje e këtyre shkeljeve dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike gjykata është dashur të bazohet në parimin “in dubio pro vas reo”, sipas dispozitës së neni 3 par.2 dhe neni 7 par.1 të KPP.

Mbrojtësja e të akuzuarit F.K.1., av.L.B., në ankesën e saj pretendon se aktgjykimi është bazuar në shkeljen e neni 384 par.1 nën par.1.8 me provë të pa pranueshme, për arsye se deklaratat e të akuzuarve dhe të dëshmitarëve gjatë fazës së hetimeve janë marrë në pyetje me kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nuk është dhënë asnjë mundësi me parashtrimin e pyetjeve gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe aktgjykimi nuk mund të bazohet në prova t tilla në procedurë penale, siç parasheh dispozita e neni 361 par.1 të KPP.

Diapozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna në arsyetim, gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, si parasheh dispozita e neni 370 par.7 të KPP; si pasoje e këtyre shkeljeve është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, dhe gjykata ka bërë ri cilësimin e veprës penale në veprën penale nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 të KPRK, e në lidhje me nenin 31, pa dhënë arsyet ligjore dhe arsyetimin se cilat ishin veprimet inkriminuese të secilit të dënuar për këtë vepër penale në bashkëkryerje. Edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, i akuzuari F.K.1., në seancën e shqyrtimit fillestar, e pranon veprën penale të falsifikimit të dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK, gjykata në kundërshtim me ligjin e pranon aktakuzën e ndryshuar PP.nr.958/20015, të dt.26.10.2015, në të cilën vepra e pranuar nga i akuzuari nuk gjendet në dispozitën e aktakuzës dhe gjykata në kundërshtim me nenin 351 të KPRK, lejoi zgjerimin e aktakuzës në të cilën i mbrojturi im ngarkohet edhe për veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave e psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPP, të sekuestruar gjatë fazës së hetimeve, pra prokuroria ka qenë në dijeni se janë konfiskuar narkotiku në sasi 6.22gr. në shtëpinë e të akuzuarit F.K.1., para ngritjes së aktakuzës me dt.06.07.2016.

Lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, ankesa pretendon se meqenëse nuk është pranuar fajësia e të akuzuarit gjykata është dashur të merr aktgjykim lirues.

Mbrojtësit e të akuzuarve F.K.2., av.B.K. dhe F.K.3., av.B.E., e të cilat ankesa janë identike pretendojnë se aktgjykimi i ankimuar është marrë të dispozitave ligjore në kundërshtim me nenin 1 të KPP, ku të akuzuarit pa pasur asnjë provë fajësuese janë shpallur fajtor, për arsye se me asnjë provë apo deklaratë të dëshmitarit nuk është vërtetuar fajësia e të akuzuarit, ndërsa gjykata aktgjykimin e bazon në deklaratat e dëshmitarëve të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor duke konstatuar se secili e njej së paku një të akuzuar dhe dëshmitarët deklarojnë se vetëm disa i njohin të akuzuarit M.K. dhe F.K.3., me pseudonimet “T... dhe L...”, mirëpo, asnjëri prej këtyre dëshmitarëve nuk cek asnjë veprim konkret për të akuzuarin F.K.3 e F.K.2.. Lidhur me vendimin mbi sanksionin penale, ankesa pretendon se e njëjtat nuk duhet të arsyetohet për arsye se vendimi mbi dënimin është i kundërligjshëm dhe të dy mbrojtësit e të akuzuarve në ankesat e tyre

kanë kërkuar që të mbrojturit e tyre të lirohen nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.N., av.M.N., në ankesën e tij, pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.1.8 të KPP, se aktgjykimi është bazuar në provë të pa pranueshme, 1.10 dhe 1.12, dhe aktgjykimi është në kundërshtim me nenin 370 par.6,7,8, të KPP, se gjykata nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit për të akuzuarin A.N. dhe nuk paraqet në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh konsideron ato të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Gjykata në arsyetimin e saj, nuk ka arsyetuar të gjitha provat materiale dhe ato formale. Gjykata në aktgjykimin e saj, vetëm konstaton se cilave prova u ka falë besimin e cilave prova nuk u ka falë besimin, duke mos i vlerësuar provat dhe aktgjykimin e mbështet mu në provat të cilat vetëm janë cekur në aktgjykim. Gjykata nuk i përshkruan saktë provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, e sidomos ato që nuk janë në favor të akuzuarit A.N..

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore për veprat penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK, për të akuzuarit F.K.1. dhe A.N., vlerëson se ndryshimi i aktakuzës dhe precizimi i saj, është bërë në pajtim me dispozitën e nenit 350 të KPP, e për të cilën të akuzuarit F.K.1. e A.N., janë shpallur fajtor, për faktin se në momentin e përpilimit të aktakuzës të dt.06.07.2016, provat lidhur me narkotikun e llojit mariuhan të cilat janë gjetur te të akuzuarit F.K.1. dhe A.N., është gjetur në shtëpitë e tyre gjatë bastisjes substanca e dyshimtë po, nuk është ditur se a bëhet fjalë për substance narkotike – pra vetë ka ekzistuar vetëm dyshimi, dhe pas ekspertizës së kryer nga agjencioni kosovar i forenzikës pasi që është vërtetuar se kemi të bëjmë me substancë narkotike të llojit mariuhan, atëherë është zgjeruar aktakuza me dt.26.10.2016, edhe për këto vepra penale për të akuzuarit F.K.1. e A.N., e kjo është bërë në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 350 të KPP, për veprat penale të përshkruara nën I/1, dhe për veprën penale të përshkruar nën I/2, të aktgjykimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit për veprat penale të cekura me lartë gjykata e shkalles së parë drejt ka aplikuar edhe ligjin penal nga neni 385 par.1 të KPP kjo për faktin se të akuzuarit F.K.1. dhe A.N. gjatë bastisjes në shtëpitë e tyre është gjetur se ata posedojnë narkotik të llojit mariuhan, të akuzuari F.K.1. 6.22gr. ndërsa të akuzuari A.N. 0.92gr. dhe gjykata drejt ka aplikuar ligjin penal për veprat penale më afër të përshkruara si në dispozitivet I/1 dhe I/2 dhe ankesat janë të pa pabazuara.

Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas ankesave të paraqitura, e duke shikuar edhe sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP, gjen se dispozitivi i aktgjykimit nën I, është i pa qartë i pa kuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe me arsyet e paraqitura në arsyetimin. Gjykata në aktgjykimin e saj të akuzuarit S.B., F.K.1., F.K.2., F.K.3., M.K., A.N. dhe G.U., i shpall fajtor për veprën penale kontrabandim me migrante, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, duke mos paraqit rrethanat objektive se të akuzuarit cilat veprime i kanë ndërmarri për transportimin e migrantëve në shtetet e Bashkimit Evropian dhe nuk paraqet se cilat ishin ato rrethanat subjektive e që të dyja këto fakte vendimtare, se cili ishte përfitimi i kundërligjshëm dobisë pasurore i të akuzuarve si elemente qenësore- qëllimin, për realizimin e veprës penale të kontrabandimit me migrantë-përfitimi i dobisë pasurore për të cilët të akuzuarit janë shpallur fajtor. Për më tepër në aktgjykim nuk jepet as një fakt vendimtar se kush është kontrabanduar, përmendet një mori dokumentesh duke filluar me pasaporta, letërnjoftime, dokumente të udhëtimit, patentë shofer, shengen viza blanko, pasaporta slovene, certifikata të lindjes, e që dispozitivin e aktgjykimit e bënë të pa qartë dhe nuk përshkruan se cilat ishin veprimet e të akuzuarve të cekur më lart të cilat i kanë ndërmarr, lidhur me kontrabandimin e migrantëve e në aktgjykim nuk kemi asnjë subjekt i cili ka qenë objekt i kontrabandimit, përveç përshkrimit të dokumenteve të cekura

më lartë, e të cilat nga shkresat e lëndës rrjedhin se janë të falsifikuara, e në anën tjetër ne aktgjykim nuk figuron asnjë prej subjekteve-personave të cilët kanë migruar ne Shtetet e Bashkimit Evropian, e po ashtu nuk kemi as përfitim kundërligjshëm të dobisë pasurore të cilat shuma janë paguar që subjekteve-personave e të cilët duhet të jenë pjesë e kontrabandimit e të cilat nuk janë paraqitur në dispozitivin e aktgjykimit, e në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor. Si rezulton nga shkresat e lëndës nuk kemi as transport, as kalim ilegal të subjekteve-personave të cilët do të ishin objekt i veprës penale të kontrabandimit me migrantë, i cili kontrabandim do të realizoj duke mos i respektuar rregullat e kalimit të kufirit me migrimin e tyre në shtetet e Bashkimit Evropian. Ne aktgjykim nuk është paraqitur asnjë subjekt i cili është objekt i kontrabandimit, vetëm përshkruhen dokumentet e falsifikuara në dispozitivin e aktgjykimit, e pa përshkrimin e veprimeve inkriminuese të akuzuarve se kush ishte objekt i kontrabandimit si element qenësor i veprës penale, si dhe qëllimi i përfitimit, e në dispozitivin e aktgjykimit, nuk janë përshkruar subjektet-personat vetëm kemi përshkrimin e dokumenteve të ndryshme të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit dhe gjykata nuk jep asnjë fakt vendimtar se për cilët persona janë përgatitur dokumentet, duke u nisur nga provat se asnjë subjekte-person, nuk është kontrabanduar, ndërsa në anën tjetër janë falsifikuar një mori dokumentesh, e gjykata lidhur me këto dokumente të falsifikuara nuk jep asnjë sqarim lidhur me qëllimin e falsifikimit të tyre, se për çfarë janë përdorur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktgjykimi i shkallës së parë përshkruan vetëm deklaratat e dëshmitareve lidhur me përpilimin e dokumenteve të ndryshme të cilat figurojnë në dispozitivin e aktgjykimit se për çfarë qëllime janë falsifikuar këto dokumente siç del nga dispozitivi i aktgjykimit e të cilat kanë qenë objekt i akuzës. Për më tepër se pjesa ndëshkuese e dispozitivit të aktgjykimit është i pa qarte dhe i pa kuptueshëm, kjo shihet se në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën ndëshkuese nuk shihet që sa kohe të akuzuarit kanë qenë në paraburgim dhe arrest shtëpiak.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata e shkallës së parë nuk i vlerëson provat e në bazë të cilave duhet të vërtetohet gjendjen faktike e cila duhet të përshkruhet në aktgjykimin e ankimuar, lidhur me veprimet inkriminuese të akuzuarve dhe në bazë të atyre veprimeve të përshkruhet edhe gjendja e vërtetuar gjë që tërësisht mungon, e në anën tjetër vetëm gjykata merret me parafrazimin e dispozitivave ligjore, dhe në fund vjen në konstatim se të akuzuarit janë shpallur fajtor për veprën penale të kontrabandimit me migrantë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në aktakuzën e ngritur me dt.06.07.2016 të akuzuarit e cekur më lartë në një përshkrim të dispozitivit të aktgjykimit janë akuzuar për veprën penale kontrabandimi i migrantëve, neni 170 par.6 lidhur me par.1 të KPRK dhe veprën penale falsifikimi i dokumenteve, neni 398 par.1 të KPRK, në shqyrtimin gjyqësor bëhet precizimi i aktakuzës, ku të akuzuarit S.B., F.K.2., F.K.3., A.N., M.K. dhe G.U., në gjendje të njëjtë faktike akuzohen se kanë kryer në grup veprën penale kontrabandim me migrant, neni 170 par.6 lidhur me par.1.2 të KPRK ndërsa i akuzuari F.K.1. dhe A.N., për veprën penale posedimi i paautorizuar i substancave narkotike, analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-se, ndërsa prokuroria publike në fjalën e saj përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës për veprën penale të kontrabandimit me migrantë, nga neni 170 par.6 lidhur me par.1.2 të KPRK-se, ndërsa për të akuzuarit F.K.1. dhe A.N., për veprën penale posedim i substancave narkotike, analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-se, dhe gjykata të akuzuarit i shpall fajtor për veprën penale kontrabandimi me migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me neni 31 të KPRK-se dhe në këtë mënyrë tërësisht i shmangët objektin të akuzës dhe cilësimit ligjor të saj dhe nuk jep asnjë fakt vendimtar se vepra penale e kontrabandimit me migrantë, nga neni 170 par.6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, a është ri cilësuar në veprën penale të kontrabandimit me migrantë nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-se, për të akuzuarit S.B., F.K.1., F.K.2., F.K.3., M.K. dhe A.N., ndërsa i akuzuari G.U., është shpallur fajtor për veprën penale kontrabandimi me migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me neni 33 të KPRK-së,

e cila fare nuk ka qenë objekt i akuzës dhe nga dispozitivi i aktgjykimit dhe arsytimit të paraqitur nuk shihet qartë se për çfarë arsye dhe për cilat fakte gjykata të akuzuarin G.e shpalli fajtor për këtë veprë penale.

Për me tepër edhe për këtë veprë penale gjykata nuk bën përshkrimin faktik të veprimeve inkriminuese të akuzuarve, dhe nuk shihen subjektet se kush është kontrabanduar në Shtetet e Bashkimit Europian, sipas par.2 të nenit 170. apo par.6 të nenit 170 e në lidhje me par.1 të njëjtës dispozitë, gjë që aktgjykimin e bën tërësisht të pa qartë të pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe arsyet e paraqitura në aktgjykim. Nga provat e administruara nuk kemi asnjë subjekt i cili është kontrabanduar në shtetet e BE, por kemi falsifikime të dokumenteve dhe nuk jep arsye të qarta se për çfarë siç del nga shkresat e lëndës dhe përshkrimi i dispozitivit të aktgjykimit i kanë falsifikuar dokumentet të cekura në aktgjykim e të cilat janë nxjerr edhe si prova, dhe Gjykata nuk jep asnjë fakt vendimtar se cilat veprime inkriminuese i kanë ndërmarr të akuzuarit në këtë çështje penale. Për më tepër gjykata nuk jep asnjë fakt vendimtar edhe për veprën penale kontrabandimime migrantë, nga neni 170 par.2 lidhur me par.1 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, për të akuzuarin G.U., i cili i ka ndihmuar të akuzuarve F.K.2., duke lëshuar me qira banesën në Prishtinë, në rr:”....”, dhe nga shkresat e lëndës nuk mund të nxirret një konkludim i qartë se i akuzuari G., a i ka ndërmarr këto veprime me dienin e tij, apo banesën e ka lëshuar me qira, me qëllim të përfitimit dhe lidhur me këtë veprë penale gjykata nuk jep asnjë fakt vendimtar ndërsa në anën tjetër të akuzuarin G.U., e shpallë fajtor.

Gjykata e Apelit, edhe pse të akuzuarit M.K. e G.U., nuk kanë paraqitur ankesë gjykata aplikoi parimin “Beneficium Cohesionis”, nga neni 397 të KPP, kjo për arsye se aktgjykimi për veprën penale të kontrabandimit me migrantë është anuluar dhe Gjykata e Apelit, çmon se edhe pse bashkë të akuzuarit, nuk kanë paraqitur ankesë, gjykata sipas detyrës zyrtare konsideron , sikurse ankesat janë paraqitur nga të akuzuarit e cekur më lartë, për arsye se anulimi i vendimit shkon edhe në dobi të tyre.

Nga ajo që u cek më lartë rezulton që ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të jenë të bazuara dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me veprën penale të kontrabandimit me migrantë, për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 dhe 8, në lidhje me nenin 361 par. 1 dhe 2 të KPP.

Për arsye të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit, nuk mund të procedoj sipas nenit 403 të KPP.

Sa i përket vendimit mbi dënimin për të akuzuarit F.K.1. dhe A.N., për veprat penale të përshkruara si në dispozitiviet I/1 dhe II/2, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të parapara si në rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit si parasheh dispozita e nenit 73 të KPRK-së. Duke marrë parasysh veprat penale për të cilën janë kryer se narkotiku ka qenë vetëm në posedim të të akuzuarit F.K.1. dhe A.N. dhe se asnjëri prej tyre nuk ka qenë i dënuar, gjë që tregon se jeta e tyre e mëparshme ka qenë në harmoni me normat pozitive të shoqërisë, ndërsa i akuzuari A.N. edhe ka pranuar fajësinë, jo nënkupton edhe pendimin e thellë të tij dhe dënimet e shqiptuara të akuzuarve janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shpalljen e përgjegjësisë penale dhe në tërësi pritët të arrihet qëllimi i ndëshkimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK-së.

Në rigjykim gjykata edhe njëherë duhet të administrojë të gjitha provat me evitimin e shkeljeve të sipër përmendura, të përshkruaj veprimet e të akuzuarve, e sidomos të vlerësoj se a kemi të bëjmë me veprën

penale të kontrabandimit me migrantë, i cili është objekt i akuzës, apo kemi të bëjmë me veprën penale të falsifikimit të dokumenteve apo ndonjë vepër tjetër penale dhe pas provave të administruara dhe vlerësimit të tyre një nga një, të bëjë përshkrimin për secilin të akuzuar për veprimet e tij dhe pas nxjerrjes së provave dhe vlerësimit të tyre, gjykata të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Si u cek edhe më lartë ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, për dispozitivet nën I/1 dhe II/2, u deshtë të refuzohen në bazë të nenit 401 të KPP, ndërsa me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, e sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, për veprën penale të përshkruara si në dispozitivin I dhe II, është anuluar dhe çështja penale është kthyer në rigjykim dhe vendim në bazë të nenit 402 par.1 KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.454/2018, me dt.06.11.2018

Procesmbajtëse,

Kimete Veseli

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetare e Kolegjit

Tonka Berishaj

PAGE

PAGE 2

